

**Projekt-Ligj**

**Nr. ....../2017 (2018)**

**“PËR REFERENDUMET”**

Në mbështetje të neneve 81 pika 1 dhe 2 shkronja “ç”, dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e .....,

**K U V E N D I  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**V E N D O S I:**

**PJESA E PARE**

**KREU I**

**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1**

**Qëllimi dhe objekti i ligjit**

Ky ligj ka për qëllim caktimin e rregullave për përgatitjen, zhvillimin, administrimin dhe shpalljen e rezultatit të referendumeve, në përputhje me dispozitat kushtetuese në Republikën e Shqipërisë.

## Neni 2 Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Referendum” – është formë e ushtrimit të drejtpërdrejtë të sovranitetit të popullit dhe shprehje e demokracisë direkte, përmes së cilës shtetasit shprehin direkt vullnetin e tyre vendimarrës përmes votës, për të pranuar ose refuzuar një çështje me rëndësi publike ose politike, në nivel qendror apo vendor.
2. “**Referendum i përgjithshëm**” – është referendumi që mbahet për ndryshimet kushtetuese, shfuqizimin e një ligji, apo për një çështje të një rëndësie të veçantë. Votimi për referendumin e përgjithshëm zhvillohet në një ditë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe rezultati i tij ka fuqi detyruese të përgjithshme.
3. “**Referendum kushtetues**” - është shprehje e drejtpërdrejtë e vullnetit popullor për pranimin ose refuzimin e amendimit të Kushtetutës.
4. “**Referendum kushtetues i drejtpërdrejtë**” – është referendum i cili thirret nga Kuvendi për çështje që lidhen me amendimin e Kushtetutës, kur vetë Kuvendi nuk shprehet paraprakisht me votë apo nuk ka dakortësi politike për projekt-amendamentet kushtetuese të paraqitura për vendimarrje.
5. “**Referendum kushtetues ratifikues**” - është referendum i cili thirret nga Kuvendi për çështje që lidhen me amendimin e Kushtetutës, kur vetë Kuvendi ka votuar më parë dhe ka miratuar ligji për amendimin kushtetues, por të cilin kërkon ta ratifikojë më votë popullore direkte, për të siguruar një konsensus sa më të gjerë, pa paragjykuar votën pro apo kundër ligjit tashmë të miratuar. Ligj i Kuvendit për amendimin e Kushtetutës që kalon më pas në referendum ratifikues merr fuqi juridike vetëm pasi konfirmohet rezultati referendar pro tij.
6. “**Referendumi i përgjithshëm konsultativ**” mbahet për një çështje legislative të rëndësisë së veçantë, për të cilën Kuvendi ose Këshilli i Ministrave, në tagrin e institucionit që ka nismën ligjvënëse, gjykon se vullneti vendimarrës është i pamjaftueshëm për t’i dhënë legjitimitetin e synuar një projekligji të caktuar apo kur vetë Kuvendi nuk arrin dot në vendimarrje për këtë çështje me mekanizmat që disponon për shkak të qëndrimeve të papajtueshme të grupeve vendimarrëse.
7. “**Referendum shfuqizues**” – është procesi që mundëson zbatimin e të drejtës kushtetuese që gëzojnë 50000 shtetas me të drejtë vote për shfuqizimin e një ligji.
8. “**Referendum konsultativ**” – quhet referendum i cili mbahet për një çështje të rëndësisë së veçantë, kur vetë Kuvendi nuk arrin dot në vendimarrje për këtë çështje me mekanizmat që disponon dhe/ose për shkak të qëndrimeve të papajtueshme të grupeve vendimarrëse të cilat mund ta dobësonin legjitimitetin e vendimarrjes së tij për këtë çështje të rëndësisë së veçantë.
9. “**Referendumi i thjeshtë**” - Referendum përgjithshëm i thirrur nga poshte-lart, nëpërmjet 50 mijë shtetasve me të drejtë vote për një çështje të rëndësisë së veçantë, për

çështje të të drejtave të njeriut, të drejtave civile dhe politike, të mirë-përdorimit të burimeve ujore dhe pasurive natyrore, çështje mjedisore, çështje të shëndetit publik, të kujdesit riprodhues të njeriut [psh aborti. etj] dhe çështje të etikës [psh.si ilustrim, eutanazia]

10. **“Referendum vendor”** – është shprehje e vetqeverisjes vendore, për çështje që kanë rëndësi për komunitetin të cilat janë nën juridiksionin dhe autoritetin vendimarrës të njërive të qeverisjes vendore.
11. **“Data e referendumit”** - është data e votimit për referendum, e caktuar me dekret të Presidentit të Republikës sipas përcaktimeve kushtetuese.
12. **“Listat e zgjedhësve”** - janë dokumente zyrtare të zgjedhësve, që burojnë nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile për çdo zonë votimi, të hartuara në përputhje me Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.
13. **“Grupi Nismëtar”** - shtetasit të cilët vihen në krye të iniciativës për mbledhjen e nënshkrimeve në rastin e referendumit legjislativ shfuqizues, si përfaqësues të qytetarëve, shoqërisë civile apo partive politike.
14. **“Komisioni Vendor”** – është komisioni që krijohet për administrimin e referendumit vendor, me funksione si ato të Komisionit të Zonave të Administrimit Zgjedhor të parashikuara në Kodin Zgjedhor.
15. **“Komisioni Zonal Zgjedhor”** është komisioni që krijohet për administrimin e procesit të votimit me funksione si ato të Komisionit të Qendrës së Votimi të parashikuara në Kodin Zgjedhor.
16. **“Njësitë e qeverisjes vendore” ose shkurt NJQV** - janë bashkitë ose qarqet, të cilat realizojnë qeverisjen vendore në Republikën e Shqipërisë sipas ligjit për vetë-qeverisjen vendore.
17. **“Organi përfaqësues”** - është këshilli bashkiak në rang bashkie dhe këshilli i qarkut në rang qarku.
18. **“Organi ekzekutiv”** - është kryetari i bashkisë në rang bashkie dhe/ose kryetari dhe kryesia e këshillit të qarkut në rang qarku.
19. **“Fushatë për referendumin”** - në kuadër të këtij ligji, fushatë për referendumin është procesi i cili përfshin çdo deklaratë e vullnetshme publike, ngjarje ose aktivitet i çdo forme apo lloji që përmban ftesën e drejtpërdrejtë apo të tërthortë për të thirrur një referendum, për të votuar pro ose kundër çështjes që shtrohet për/në referendum dhe çdo ftesë e drejtpërdrejtë ose e tërthortë për të marrë ose jo pjesë në një referendum deri 24 orë para zhvillimit të votimit.
20. **“Votim elektronik”** – është procesi i votimit përmes mjeteve/mënyrave elektronike, përmes të cilit merret mendimi i shtetasve me anë të nëshkrimit elektronik, për çështje të caktuara të shtruara në referendum.
21. **“Rezultati përfundimtar i referendumit”** - është rezultati i nxjerre nga KQZ-ja, apo nga komisioni vendor dhe që përfshin rezultatin e votimit për çdo alternativë në referendum, sipas dispozitave të këtij ligji dhe Kodit Zgjedhor.

### **Neni 3**

#### **Parime të përgjithshme**

1. Sovraniteti në Republikën e Shqipërisë i përket popullit. Populli e ushtron sovranitetin nëpërmjet përfaqësuesve të tij ose drejtpërsëdrejti. Referendumi është një nga format e ushtrimit të drejtpërdrejtë të sovranitetit të popullit.
2. Referendumet mund të jenë të përgjithshme ose vendore. Vendimet e marra në referendum të përgjithshëm kanë fuqi juridike mbi të gjithë territorin e RSH, kurse vendimet e marra me referendum vendor kanë fuqi juridike vetën në territorin juridiksional të bashkisë apo qarkut ku mbahet referendumi.
3. Parimet dhe rregullat për zhvillimin e referendumit, në nivel qendror dhe vendor, si dhe procedura dhe vlefshmëria e rezultateve të tij përcaktohen përmes këtij ligji.

### **Neni 4**

#### **E drejta për Referendum**

1. E drejta për referendum garantohet nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë si formë e ushtrimit të drejtpërdrejtë të sovranitetit të popullit.
2. Çdo shtetas shqiptar, brenda apo jashtë vendit, me të drejtë vote, që plotëson kushtet për të qenë zgjedhës, ka të drejtë të marrë pjesë në referendum.
3. Shteti, përmes institucioneve dhe financave publike, garanton që shtetasit shqiptarë në referendum të shprehin vullnetin e tyre në mënyrë të drejtpërdrejtë, me votim të lirë e të fshehtë.
4. Qytetarët e ushtrorinë lirisht të drejtën për të marrë pjesë dhe votuar në referendum. Çdo formë kontrolli apo influence e ushtruar ndaj vullnetit të lirë të votuesve është e ndaluar.

### **Neni 5**

#### **Transparenca e Procesit Referendar**

1. E gjithë procedura për mbajtjen e referendumit duhet të jetë transparente dhe publike. Ky ligj ngarkon KQZ dhe institucionet publike që kanë një rol ligjor të përcaktuar në zhvillimin dhe administrimin e procesit zgjedhor me detyrimin për të garantuar mbarëvajtjen e referendumit.
2. Çdo shtetas me të drejtë vote në Republikën e Shqipërisë i garantohet nga shteti e drejta për t'u njohur paraprakisht dhe efektivisht përmes mjeteve të komunikimit masiv për nismën referendare, për çështjet e shtruara për referendum, opsionet e votimit, qendrat e votimit si dhe procedurën e votimit.
3. Thirrja e referendumit, kontrolli i vlefshmërisë së nismës, administrimi i procesit të votimit për referendumin dhe nxjerrja e rezultatit bëhen në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe ato të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

**Neni 6**  
**Pergjegjesia institucionale dhe Kostot financiare**

1. Institucioni kryesor përgjegjës për zbatimin e këtij ligji është Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve.
2. Institucionet, në nivel qëndror apo vendor, të cilat kërkojnë apo autorizojnë zhvillimin e një procesi referendar janë gjithashtu përgjegjëse zbatimin e dispozitave të këtij ligji.
1. Grupi Nismëtar është përgjegjës vetëm për nisjen e procesit referendar, konform përcaktive që përmban ky ligj, por nuk mban përgjegjësi për zhvillimin, kostot dhe mbarëvajtjen e referendumit.
2. Sipas rastit, organe mund të bashkëpunojnë edhe me organe dhe institucione të tjera publike apo me organizata të shoqërisë civile dhe parti politike.
3. Kostot për mbajtjen e referendumeve përballohen plotësisht nga shteti.

**Neni 7**  
**Kufizimet e të drejtës për referendum**  
**(e hapur per inpute nga partneret e SHC)**

1. Çështjet që lidhen me tërësinë territoriale të Republikës së Shqipërisë, me kufizimin e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut, me buxhetin, taksat e detyrimet financiare të shtetit, me vendosjen dhe heqjen e gjendjes së jashtëzakonshme, me deklarimin e luftës dhe të paqes dhe me amnistinë nuk mund të shtrohen në referendum.
2. Asnjë referendum nuk mund të zhvillohet datën e zgjedhjeve për Kuvend ose për organet e qeverisjes vendore.
3. Nuk mund të zhvillohet referendum i përgjithshëm gjatë periudhës nga 3 muaj para përfundimit të mandatit të Kuvendit, deri tre muaj pas mbledhjes së parë të Kuvendit të ri.
4. Nuk mund të zhvillohet referendum vendor brenda 10 muaj nga fillimi i mandatit të organit të qeverisjes vendore, brenda 12 muajve nga data e referendumit të fundit të zhvilluar për të njëjtën çështje apo 12 muaj para përfundimit të mandatit të organeve të qeverisjes vendore.
5. Kur shpallen zgjedhje të parakohshme për Kuvendin, procedura për zhvillimin e referendumit pezullohet deri pasi të kenë kaluar tre muaj nga mbledhja e parë e Kuvendit të ri.
6. Kur në një njësi të qeverisjes vendore shpallen zgjedhje të parakohshme, procedura për zhvillimin e referendumit vendor në atë njësi pezullohet deri pasi të kenë kaluar 10 muaj nga fillimi i mandatit të organit të qeverisjes vendore.
7. Gjatë periudhës së zbatimit të masave të jashtëzakonshme nuk mund të zhvillohen asnjë referendum.

**(e hapur per inpute nga Partneret)**

## KREU II

### LLOJET E REFERENDUMEVE DHE NISMETARET

#### Neni 8

##### Llojet e referendumeve

1. Referendumet në Republikën e Shqipërisë mund të jenë të përgjithshme ose vendore.
2. Referendumet e përgjithshme kanë fuqi juridike në të gjithë territorin e vendit, kurse ato vendore kanë fuqi juridike vetëm në territorin juridiksional të njësisë së qeverisjes vendore.
3. Referendumet vendore mund të zhvillohen në Nivel Qarku ose në Nivel Bashkie. Në rast të ndryshimit me ligj të niveleve të qeverisjes vendore, referendumet vendore zhvillohen në ato nivele të organizimit territorial apo administrativ që caktohen me ligjin e ri për ndarjen administrative dhe territoriale.
4. Referendumet mund të organizohen me nismën e organit përfaqësues [vendimarrës] në nivel qendror ose vendor. Në një rast të tillë ato quhen klasifikohen si referendume me iniciativë nga Lart-Poshtë
5. Referendumet, mund të organizohen me nismën e drejtpërdrejtë të qytetarëve me të drejtë vote. Në një rast të tillë ato klasifikohen si referendume me iniciativë nga Poshtë –Lart.
6. Qytetarët kanë të drejtë të marrin nismën për të zhvilluar referendum të përgjithshëm ose vendor, konform parimeve dhe rregullave që përmban ky ligj.

#### Neni 9

##### Referendumi kushtetues

1. Referendumi kushtetues është shprehje e drejtpërdrejtë e vullnetit të popullit për pranimin ose refuzimin e amendimit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
2. Kuvendi mund të vendosë, me dy të tretat e të gjithë anëtarëve të tij, që projekt-amendamentet kushtetuese të votohen direkt me referendum në popull pa u votuar paraprakisht në seancë plenare në Kuvend. Në këtë rast ai quhet **Referendum Kushtetues i drejtpërdrejtë**.
3. Kuvendi mund të miratojë vetë më parë amendamentet kushtetuese dhe më pas të kërkojë ratifikimin e ligjit kushtetues të miratuar prej tij përmes referendumit kur këtë e kërkon një e pesta e të gjithë anëtarëve të Kuvendit. Në këtë rast ai quhet **Referendum Kushtetues ratifikues**.

## **Neni 10**

### **Nisma për Refendumin Kushtetues**

1. Nisma për referendumin kushtetues i takon Kuvendit i cili shprehet me ligj për thirrjen e tij si në rastin kur ai është i drejtpërdrejtë ashtu edhe kur ai është ratifikues.
2. Referendumi Kushtetues zhvillohet jo më vonë se 60 ditë nga data në të cilën ligji autorizues i Kuvendit ka marrë fuqi juridike përmes botimit në Fletore Zyrtare.
3. Presidenti i Republikës nuk ka të drejtë ta kthejë për rishqyrtim ligjin e miratuar nga Kuvendi për rishikimin/ratifikimin e Kushtetutës me Referendum.
4. Referendumi kushtetues shtron për vendimarrje direkte në popull vetëm dy opsione, “PRO” ose “KUNDER”.
5. Ligji Kushtetues i cili shtrohet për Referendum, quhet i **ratifikuar** kur PRO tij të kenë votuar më shumë se gjysma e qytetarëve që kanë marrë pjesë në votim. Në të kundërt, ligji konsiderohet i shfuqizuar.
6. Ligji kushtetues i miratuar apo ratifikuar me referendum shpallet solemnisht nga Presidenti i Republikës, jo më vonë se 24 orë pasi KQZ bën publik rezultatin e votimit dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletore Zyrtare.
7. Rishikimi i Kushtetutës për të njëjtën çështje nuk mund të bëhet përpara se të kenë kaluar 3 vjet nga dita e rrëzimit të tij në referendum.

## **Neni 11**

### **Referendumi i përgjithshëm konsultativ**

**(e hapur për sugjerime tek titulli, meqe thirret nga lart-poshte)**

1. Referendum konsultativ mbahet për një çështje legislative të rëndësishme së veçantë, për të cilën Kuvendi ose Këshilli i Ministrave, në tagrin e institucionit që ka nismën ligjvënëse, gjykon se vullneti vendimarrës brenda këtyre institucioneve është i pamjaftueshëm për t'i dhënë legjitimitetin e synuar një projekligji të caktuar.
2. Referendumi konsultativ mund të thirret edhe në rastet kur vetë Kuvendi nuk arrin dot në vendimarrje për një çështje të caktuar apo të një rëndësie të veçantë me mekanizmat legjislativë që disponon. Në këtë rast Kuvendi rikthen tagrin/atributet vendimarrëse tek sovranin, i cili thirret në referendum për të vendosur direkt mbi çështjen konkrete.
3. Kuvendi shprehet me ligj për mbajtjen/thirrjen e referendumit të përgjithshëm konsultativ.
4. Presidenti i Republikës nuk ka të drejtë ta kthejë për rishqyrtim ligjin e miratuar nga Kuvendi për miratimin e një ligj përmes referendumit.
5. Ligji i miratuar me referendum shpallet nga Presidenti i Republikës solemnisht, jo më vonë se 24 orë pasi KQZ bën publik rezultatin e votimit dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletore Zyrtare.

## Neni 12

### Nisma për Referendumin e përgjithshëm konsultativ

1. Kuvendi, me propozimin e jo më pak se një të pestës së deputetëve, mund të vendosë që ratifikimi i një apo disa marrëveshjeve ndërkombëtare të bëhet me referendum të përgjithshëm konsultativ **(neni 123 i kushtetues)**.
2. Kuvendi shprehet me ligj për ratifikimin me referendum të marrëveshjeve ndërkombëtare. Ky ligj miratohet me shumicën e të gjithë anëtarëve të Kuvendit.
3. Kuvendi, me propozimin e jo më pak se një të pestës së deputetëve mund të vendosë që një projektligji i rëndësisë së veçantë të shtrohet (kthehet) për vendimarrje direkte në popull me referendum të përgjithshëm. Në këtë rast, Kuvendi konsiderohet nismëtar i referendumit.
4. Kuvendi, me propozimin e Këshillit të Ministrave, mund të vendosë që një projektligji i rëndësisë së veçantë, nismën ligjore për të cilin e ka marrë Këshilli i Ministrave të shtrohet (kthehet) për vendimarrje direkte me referendum të përgjithshëm. Në këtë rast, Këshilli i Ministrave konsiderohet nismëtar i referendumit.
5. Ligji autorizues i Kuvendit për mbajtjen e referendumit të përgjithshëm konsultativ për projektligje të veçanta duhet të miratohet me kuorumin e parashikuar në Kushtetutë për atë ligj të posaçëm.

**(e hapur per komente) a duhet dhene shumice e cilesuar per ligjet organike dhe a duhet dhene shumice jo e cilesuar per ligjet e thjeshte ne ligjin autorizuesd per kuvendin...**

## Neni 13

### Referendumi shfuqizues

1. Populli, nëpërmjet 50 mijë shtetasve me të drejtë vote, ka të drejtën e thirrjes së referendumit për shfuqizimin e një ligji të Kuvendit.
2. Një ligj i Kuvendit quhet i shfuqizuar kur në referendumin e organizuar për këtë qëllim kanë votuar PRO më shumë se gjysma e votuesve që kanë marrë pjesë në referendum.
3. Ligji i shfuqizuar me referendum humbet fuqinë e tij juridike jo më parë se 6 muaj nga data e shpalljes së rezultatit të referendumit dhe jo më vonë se një vit nga shpallja e këtij rezultati.
4. Kostot financiare të rikuperuara nga shfuqizimi me referendum i një ligji, rialokohen në ligjin pasardhës të buxhetit të shtetit ose buxhetin afat-mesëm, nëse kjo konsiderohet e mundur ose e nevojshme



## Neni 14

### Nisma për Referendumi shfuqizues

5. Nisma për mbajtjen e një referendumi shfuqizues mund të merret nga të paktën 15 shtetas shqiptare me të drejtë vote, ose nga organizatat e shoqërisë civile dhe/ose partitë politike të regjistruara sipas legjislacionit në fuqi.
6. Nisma për referendum shfuqizues duhet të hartohet në formën e një propozimi të shkruar, i cili duhet të përmbajë ligjin që kërkohet të shfuqizohet si dhe një apo disa argumenta kryesorë PRO shfuqizimit të tij.
7. Propozimi referendar, **pasi merr pëlqimin e 50 mijë shtetasve** me të drejtë vote, i paraqitet nga përfaqësuesit e autorizuar Presidentit të Republikës dhe për dijeni Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve së bashku me kërkesën zyrtare për mbajtjen e referendumit.
8. Me marrjen e kërkesës për mbajtjen e referendumit, KQZ njofton zyrtarisht brenda 5 ditëve Kuvendin mbi propozimin e ardhur për referendum.
9. Gjykata Kushtetuese shqyrton paraprakisht kushtetutshmërinë e çështjeve të shtruarra për referendum shfuqizues vetëm kur ka pretendime për këtë qëllim.
10. Palë e legjitimuara për të ngritur pretendime në GJK kundër Propozimit për Referendum Shfuqizues është vetëm Kuvendi i Shqipërisë, i cili e ushtron këtë drejtë brenda 15 ditëve nga depozitimi i propozimit për referendum në KQZ nga Grupi Nismëtar.
11. **Kuvendi disponon me ligj [duhet konsulte...kuvendi duhet të disponoje me vendim apo me ligj.... keshilli i legjislacionit ???kush merr vedimin per te atakuar referendumin shqfuzues????]**
12. Afati maksimal brenda të cilit Gjykata Kushtetuese duhet të shprehet me vendim të arsyetuar dhe me fuqi të plotë juridike, mbi kushtetutshmërinë e nismës referendare është 60 ditë nga paraqitja e kërkesës.
13. **Opsion: Mos-shprehja në afat është lejim, pavarësisht dispozitivit të vendimit të Gjykatës Kushtetuese**

## Neni 15

### Referendumi i thjeshtë

(e hapur për sugjerime tek titulli, meqe thirret nga poshtë-lart)

1. **Populli, nëpërmjet 50 mijë shtetasve me të drejtë vote, ka të drejtën t'i kërkojë Presidentit të Republikës zhvillimin e referendumit për çështje të një rëndësie të veçantë.**
2. Referendumi i thjeshtë mbahet për çështje të drejtave të njeriut, të drejtave civile dhe politike, të mirë-përdorimit të burimeve ujore dhe pasurive natyrore, çështje mjedisore, çështje të shëndetit publik, të kujdesit riprodhues të njeriut (psh aborti etj) dhe çështje të etikës (psh.si ilustrim, eutanazia)

3. Referendumi i thjeshte mund të mbahet edhe për ratifikimin ose jo të një marrëveshje ndërkombëtare në përputhje me nenin 123 paragrafin 3 të Kushtetutës si dhe për çështje që lidhen me vendimin për t'u bashkuar apo dalë nga një aleancë apo organizatë.
4. Referendumi i thjeshtë mund të thirret edhe për çështje të vetë-taksimit për një dobi të caktuar publike.

## **Neni 16**

### **Nisma për referendum të thjeshtë**

1. Nisma për mbajtjen e një referendumi të thjeshtë mund të merret nga të paktën 15 shtetas shqiptare me të drejtë vote (grupi nismëtar), organizatat e shoqërisë civile dhe partitë politike të regjistruara sipas legjislacionit në fuqi, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.
2. Nisma për referendum duhet të përmbajë një propozim konkret, i cili hartohet me shkrim, nënshkruhet nga anëtarët e grupit nismëtar dhe depozitohet zyrtarisht në KQZ.
3. Me marrjen e kërkesës për mbajtjen e referendumit, KQZ-ja njofton Kuvendin, brenda 5 ditëve në lidhje me propozimin e ardhur si dhe Presidentin e Republikës, kur është rasti për të shtruar në referendum një çështje me rëndësi të veçantë.
4. Procedura për mbledhjen e nënshkrimeve të zgjedhësve për aktivizimin e nismës për referendum kryhet sipas mënyrës së përcaktuar me këtë ligj.

## **Neni 17**

### **Referendumi vendor**

1. Vetë-qeverisja dhe vendimarrja në njësitë e qeverisjes vendore ushtrohet edhe përmes referendumeve vendore, si formë e demokracisë së drejtpërdrejtë.
2. Referendum vendor mund të zhvillohet në nivel qarku ose në nivel bashkie.
3. Referendumi vendor mund të zhvillohet për:
  - a) çështje që prekin bashkësinë dhe që përfshihen brenda kompetencave të organeve të NJQV
  - b) vetëtaksimin e banorëve për qëllime publike, brenda kufijve të detyrave dhe kompetencave të organeve të bashkisë;
  - c) shkarkimin e organit drejtues të NJQV;
  - d) çështje të tjera me natyrë shoqërore, ekonomike, apo kulturore për të cilat bashkësia/komuniteti shfaq interes të posaçëm;

**Neni 18**  
**Nisma për referendumin vendor**

1. Nismën për zhvillimit e referendunit vendor e kanë të paktën 15 shtetas shqiptar me të drejtë vote që janë banorë të njësisë në të cilën thirret referendumi vendor, ose një organizatë e shoqërisë civie që ka personalitet juridik, veprimtaria aktive e të cilës, sipas statutit të saj, është e shtrirë të paktën në territorin e NJQV ku thirret/mbahet referendum vendor.
2. Procedurat për zhvillimin e referendunit vendor përcaktohen në Pjesën 2 të këtij ligji.

**KREU III**  
**AKTIVIZIMI I PROCESIT REFERENDAR (OPSIONALE)**

**SEKSIONI 1**  
**Referendumet me nismen e Kuvendit/Keshillit te Ministrave**

**Neni 19**  
**Aktivizimi i referendumi te pergjithshem kushtetues**

1. Propozimi për referendumin kushtetues duhet të përcaktojë qartë tekstin me dispozitat që do të votohen me referendum.
2. Drafti i propozuar për të kaluar në referendum shqyrtohet në seancën e radhës së Kuvendit, në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.
3. Data për thirrjen e referendunit duhet të jetë jo më vonë se tre muaj nga vendimi i Kuvendit për këtë qëllim.
4. Drafti i miratuar nga Kuvendi, me dy të tretat e të gjithë anëtarëve të tij, i kalon KQZ-së për të procedura më tej me organizimin për mbajtjen e referendunit.

**Neni 20**  
**Aktivizimi i referendunit të pergjithshëm konsultativ**

1. Jo më pak se 1/5 e deputetëve ose Këshilli i Ministrave mund të paraqesin në Kuvend një propozim për referendum, sipas përcaktimeve kushtetuese dhe të këtij ligji.
2. Propozimi për referendum duhet të përcaktojë: natyrën e referendunit dhe tekstin e propozuar për t'u votuar me referendum.
3. Drafti i propozuar për të kaluar në referendum, do të shqyrtohet në seancën e radhës së Kuvendit, në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

4. Data për thirrjen e referendumit duhet të jetë jo më vonë se tre muaj nga vendimi i Kuvendit për këtë qëllim.
5. Drafti i miratuar nga Kuvendi, i kalon KQZ-së për të procedura më tej me organizimin për mbajtjen e referendumit.

## **SEKSIONI 2**

### **Referendumi i zhvilluar me nismën e shtetasve**

#### **Neni 21**

##### **Grupi Nismëtar**

1. Për të thirrur një referendum shfuqizues apo thjeshtë [nga poshtë-lart] është i domosdoshëm krijimi i një grupi nismëtar i cili përbëhet nga të paktën 15 shtetas shqiptarë me të drejtë votë.
2. Kur inisiativa për referendum merret nga organizata të shoqërisë civile apo subjekte politike, krijohet një Komitet Përfaqësues brenda Grupit Nismëtar, me pjesëmarrjen e një përfaqësuesi për secilin prej subjekteve.
3. Për të thirrur një referendum kushtetues apo konsultativ (nga lart poshtë) grup nismëtar konsiderohet 1/5 e anëtarëve të Kuvendit të cilët kanë firmosur kërkesën për mbajtjen e referendumit.

#### **Neni 22**

##### **Projekti i propozuar për referendum**

1. Projekti i propozuar për referendum duhet të përmbajë:
  - a) llojin e referendumit dhe arsyen e zhvillimit të tij;
  - b) subjektin(et) nismëtar;
  - c) tekstin e propozuar për referendum, të hartuar sipas përcaktimeve të këtij ligji.
  - d) nënshkrimet e grupit nismëtar
  - e) personin që do të atashohet pranë KQZ për të koordinuar procesin referendar
  - f) nëse propozues janë organizatat e shoqërisë civile dhe/ose partitë politike, projekti i propozuar duhet të përmbajë përveç nënshkrimeve, edhe vulën e subjektit juridik.

#### **Neni 23**

##### **Mbledhja e nënshkrimeve**

1. Me marrjen e vendimit nga KQZ-ja, Grupi Nismëtar/Komiteti Përfaqësues bën publike këtë inisiativë për referendum me mjete të ndryshme publike, duke treguar edhe

modalitetet e organizimit të kësaj inisiative, aktivitetet që do të kryhen në vijim për mbështetjen e referendumit, vendet dhe oraret përkatëse.

2. KQZ akordon një fond të posaçëm në dispozicion të informimit të publikut për nismën referendare të hapur për nënshkrime, mënyrat e mbledhjes së firmave dhe dokumentacionin e kërkuar për këtë qëllim.
3. KQZ ka detyrimin për të ofruar dhe garantuar informim efektiv përmes medias audio-vizuale me mbulim kombëtar lidhur me qëllimin e nismës referendare, afatet e grumbullimit të firmave dhe shpërndarjen e tyre gjeografike, si dhe të raportojë publikisht në media, përmes kryetarit apo personave të ngarkuara prej tij mbi ecurinë e procesit të nënshkrimit të paktën tre herë.
4. Mbledhja e nënshkrimeve për referendum bëhet në vende publike, sipas përcaktimeve që bën Grupi Nismëtar/Komiteti Përfaqësues në çdo njësi të qeverisjes vendore. Grupi Nismëtar/Komiteti Përfaqësues mund të vendosë që të aktivizojë vullnearatë për të mbledhur firma derë më derë, duke detajuar paraprakisht protokollin e komunikimit të vullnearëve me nënshkruesit.
5. KQZ vë në dispozicion të procesit të mbledhjes së firmave për referendum të gjithë bazën materiale të nevojshme, me fletë të sigluara prej saj, sipas specifikime teknike të përcaktuara.
6. Formati që përdoret në këtë rast, për mbledhjen e nënshkrimeve duhet të përmbajë:
  - a) çështjen që shtrohet për referendum
  - b) numrin rendor,
  - c) emrin dhe mbiemrin e votuesit,
  - d) numrin e kartës së identitetit apo pasaportës,
  - e) datëlindjen,
  - f) vendlindjen dhe vendbanimin,
  - g) nënshkrimin dhe datën

#### **Neni 24**

#### **Nënshkrimi elektronik**

1. Nënshkrimet mund të mblidhen edhe në rrugë elektronike, online përmes portalit që mundësohet për këtë qëllim sipas përcaktimeve që bën Grupi Nismëtar/Komiteti Përfaqësues i referendumit, në përputhje me standartet e pranuar për nënshkrimin elektronik dhe ofruesit e këtij shërbimi, nga legjislacioni në fuqi.
2. Ofruesit e shërbimit të certifikimit për mbledhjen e nënshkrimeve elektronike online duhet të garantojnë mbrojtjen e të dhënave personale dhe identifikimin e nënshkrimeve. Mbledhja e nënshkrimeve online është pa pagesë.
3. Në çdo rast, pas një nënshkrimi online në portalin përkatës, sistemi mundëson printimin e një certificate që e provon këtë nënshkrim.

4. KQZ, me kërkesë të saj ose të Grupi Nismëtar/Komiteti Përfaqësues, vendos në dispozicion faqen e vet zyrtare për të mbledhur nënshkrime elektronike online mbi nismën e referendumit. KQZ informon zgjedhësit përmes një tutoriali shpjegues në audio-video në faqen e vet zyrtare mbi mënyrën se si funksionon nënshkrimi elektronik, si dhe mbi mënyrën e depozitimit të firmave elektronike për nismën konkrete referendare të hapur për nënshkrim nga zgjedhësit.
5. Në përfundim të afatit sic përcaktohet me këtë ligj, administrator i portalit i dorëzon Grupit Nismëtar/Komitetit Përfaqësues certifikatat e printuara, të cilat bëhen pjesë e dokumentacionit që i dorëzohet KQZ-së.

## **Neni 25**

### **Afati për mbledhjen e nënshkrimeve**

1. Periudha për mbledhjen e nënshkrimeve është 3 muaj nga marrja e vendimit të KQZ-së për regjistrimin e iniciativës propozuese për referendum. Nëse brenda kësaj periudhe, minimumi i kërkuar prej 50000 nënshkrimeve nuk mblidhet, atëherë kjo procedurë për propozimin e këtij referendumi nuk ka më vlerë dhe mbledhja e nënshkrimeve ndërpritet.
2. Nëse brenda periudhës 3 mujore të përcaktuar, mblidhet të paktën minimumi i nënshkrimeve të domosdoshme, atëherë Grupi Nismëtar/ Komiteti Përfaqësues i iniciativës për referendum, i dorëzon KQZ-së dokumentacionin me nënshkrimet përkatëse.

## **Neni 26**

### **Verifikimi i nënshkrimeve**

1. Me paraqitjen e nënshkrimeve dhe dokumentacionit përkatës nga Grupi Nismëtar/Komiteti Përfaqësues, KQZ-ja bën numërimin e firmave të mbledhura si dhe verifikimin e vlefshmërisë së nënshkrimeve brenda 10 ditëve nga depozitimi i tyre në KQZ.
2. Në rast se nga verifikimi rezultojnë nënshkrime jo-autentike, atëherë KQZ i identifikon ato dhe i zbret nga numri total i firmave të grumbulluar për aktivizimin e nismës referendare. Nënshkrimet jo-autentike numërohen dhe identifikohen për aq sa janë dhe nuk mund të anulojnë autenticitetin dhe vlefshmërinë e firmave të tjera të grumbulluar nga Grupi Nismëtar/ Komiteti Përfaqësues.
3. Në rast se numri i nënshkrimeve jo-autentike të konsideruara si të pavlefshme nga KQZ është më pas se 5% e totalit të kërkuar për të propozimin e Referendumit, KQZ rihap procesin e mbledhjes së firmave nga e para për një periudhë 10 ditore. Në këtë rast, KQZ-ja njofton Kuvendin dhe Grupin Nismëtar/Komitetin Përfaqësues.
4. Në çdo rast, KQZ-ja del me vendim të arsyetuar.

**Neni 27**  
**Kontrolli nga Gjykata Kushtetuese**

1. Gjykata Kushtetuese shqyrton paraprakisht kushtetutshmërinë e çështjeve të shtruara për referendum si dhe bën verifikimin e rezultateve përfundimtare të tij, kur ka pretendime për këtë qëllim, sipas nenit 150 paragrafët 1 e 2, nenit 151 paragrafët 2 e 3 edhe sipas nenit 177 paragrafët 4 e 5 të Kushtetutës, brenda 60 ditëve nga paraqitja.
2. Rëndësia e çështjeve të veçanta për t'u votuar me referendum, të parashikuara në nenin 150 paragrafët 1 e 2 të Kushtetutës, nuk është objekt gjykimi në Gjykatën Kushtetuese.
3. Gjykata Kushtetuese, në rastin kur vihet në lëvizje për shqyrtimin e një ligji për rishikimin e Kushtetutës, të votuar me referendum, sipas nenit 177 të Kushtetutës, kontrollon vetëm respektimin e procedurës së parashikuar nga Kushtetuta.

[e hapur per inpute - Te shtohet me shume...nese eshte e nevojshme]

**Neni 28**  
**Data e referendumit**

1. Data e referendumit caktohet nga Presidenti i Republikës brenda 45 ditëve pas shpalljes së vendimit të Gjykatës Kushtetuese për vlefshmërinë e nismës, ose pas kalimit të afatit brenda të cilit Gjykata Kushtetuese duhet të shprehej.
2. Referendumi zhvillohet jo më parë se 45 ditë dhe jo më vonë se 90 ditë nga data e plotësimit të kushteve të përcaktuar në paragrafin 1.
3. Çështjet e shtruara për t'u votuar me referendum të përgjithshëm në një vit, mund të jenë disa, por votimi për to zhvillohet në një ditë të vetme.

**KREU IV**  
**ADMINISTRIMI I PROCESIT ZGJEDHOR PËR REFERENDUMET**

**Neni 29**  
**Roli dhe kompetencat e KQZ-së**

1. Procesi zgjedhor referendar administrohet nga Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve, në bashkërendim me Grupin Nismëtar dhe institucionet e tjera ligjzbatuese të cilat kanë detyrimin me ligj të garantojmë mabrëvajtjen e procesit zgjedhor në Republikën e Shqipërisë.
2. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka këto detyra dhe përgjegjësi:

- a) Garanton dhe mbikqyr ligjshmërinë dhe siguron zbatimin e drejtë dhe të barabartë të parashikimeve ligjore për mbajtjen e referendumit;
  - b) drejton punën e komisioneve për referendimet dhe shqyrton vendimet e miratuara nga komisionet e referendumit;
  - c) trajton ankesat e ardhura në lidhje me procedurën e organizimit dhe zhvillimit të referendumeve;
  - ç) jep sqarime dhe udhëzime për zbatimin e këtij ligji;
  - d) nxjerr vendime dhe akte të tjera për zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe të detyrueshme për të gjitha komisionet dhe organet;
  - dh) disponon mjetet financiare të alokuara për mbajtjen e referendumeve, shpërndarjen e tyre dhe mbikqyr mënyrën e përdorimit të tyre për mbajtjen e referendumeve;
  - e) merr masa për sigurimin e materialeve, mjeteve e bazës teknike si dhe mjeteve të komunikimit përkatëse për të garantuar zhvillimin normal të referendumit;
  - ë) përcakton modelin e fletëve të votimit për referendumin si dhe dokumente të tjera të referendumit;
  - f) përcakton formën e vulës që vendoset në fletët e votimit dhe në gjithë dokumentacionin që shoqëron zhvillimin e referendumit, si dhe përcakton procedurën për kthimin e vulave pas referendumit;
  - g) siguron publikimin në media të draftit të paraqitur në referendum;
  - gj) akrediton përfaqësuesit e mediave dhe organizatave ndërkombëtare zbatimin që kryejnë misionë vëzhgimi, sipas një procedure të përcaktuar nga vetë ky institucion;
  - h) përcakton një procedurë të vetme për përmbledhjen dhe finalizimin e rezultateve të referendumit;
  - i) në përputhje me kërkesat e Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë përmbledh dhe shpall rezultatet e referendumit, si dhe procedurën e dorëzimit të dokumentacionit të përdorur në referendum;
  - j) organizon trajnime për anëtarët e komisioneve të referendumit;
  - k) në rast të shkeljes së kërkesave të këtij ligji, për çështje të organizimit të referendumit, mund t'i drejtohet organeve kompetente përkatëse;
3. Kompetencat e tjera të përcaktuara në këtë ligj dhe në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

### **Neni 30**

#### **Fushata për referendumin dhe pasqyrimi në media**

1. Brenda fushëveprimit të këtij ligji, periudha e fushatës përpara një referendumi do të jetë periudha prej ditës së njoftuar për një referendum deri në ditën e zhvillimit të referendumit.



2. Vendimi për mbajtjen e referendumit, do të bëhet publik në media jo më vonë se 45 ditë para ditës së mbajtjes së referendumit. Qytetarët duhet të informohen në lidhje me referendumin nëpërmjet një apeli publik dhe vënies së posterave apo shpërndarjes së materialeve të tjera në vende të dukshme, të përcaktuara për këtë qëllim.
3. Teksti i propozimit që do të vendoset në referendum shpallet publikisht në media.
4. Media nuk mban përgjegjësi për saktësinë e të dhënave që përmbahen në materialet e gatshme të fushatës të cilat u janë dorëzuar atyre për pasqyrim publik.
5. Fushata për referendumin dhe pasqyrimi i saj mediatic, si dhe sondazhet e ndryshme që mund të zhvillohen për referendumin, mbyllen 24 orë para votimit në referendum.
6. Në këto kufizime, nuk përfshihet pasqyrimi në media i procesit të votimit dhe pjesë të transmetimit në edicionet e lajmeve të këtij procesi.

### **Neni 31**

#### **Fleta e votimit për referendum**

1. Jo më vonë se 30 ditë nga marrja e vendimit, KQZ-ja përgatit edhe formatin e fletës së votimit për referendum, duke pasqyruar në të propozimin për ligjin apo çështjen që i nënshtrohet referendumit.
2. Formatin e fletës së votimit duhet të jetë prej letre, me ngjyrë, trashësi ose elemente konfigurimi të tilla që të mos lejojë leximin e votës në pjesën e pasme të saj, si dhe të përmbajnë elemente sigurie, sipas përcaktimeve të KQZ-së.
3. Formatin e votimit është i njëjtë për të gjithë territorin e vendit.
4. Formatin e lëshuar nga KQZ-ja për mbledhjen e nënshkrimeve të votuesve duhet të përmbajë tekstin e mëposhtëm:  
*“Unë, shtetas i Republikës së Shqipërisë, vërtetoj se mbështes inisiativën e propozuar për të thirrur një referendum mbi .....(paraqitet i gjithë teksti i propozuar për referendum)”*.
5. Kostot për përgatitjen e fletëve tip për mbledhjen e nënshkrimeve mbulohen nga KQZ-ja.
6. Fleta e votimit duhet të përmbajë në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme tekstin e propozuar për referendum, sipas natyrës së referendumit të përcaktuar në këtë ligj, duke u kërkuar votuesve të shprehen për një nga alternativat të dhëna në variantin “Po” ose “Jo”, apo në variantin “Pro” ose “Kundër”.

### **Neni 32**

#### **Votimi**

1. Procedurat, dokumentacioni, administrimi i tij si dhe rregullat e votimit, e numërimit të votave, në referendum përcaktohen nga Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë dhe ky ligj.

2. Çdo votues ka të drejtën vetëm të një vote, të cilën duhet ta shprehë lirisht dhe drejtpërdrejtë. Vota është vetjake, e fshehtë, dhe çdo votë e dhënë ka të njëjtën vlerë.
3. Votuesi zgjedh vetëm një nga alternativat e dhëna në fletët e votimit, sipas mënyrës së votimit që ka përcaktuar KQZ-ja për këtë qëllim.
4. E drejta e votës në referendum i garantohet edhe çdo shtetasi shqiptar me të drejtë vote që ndodhet jashtë vendit. Në këtë rast, KQZ-ja bashkëpunon me përfaqësitë tona diplomatike dhe votimi në referendum ndjek të njëjtën procedurë siç përcaktohet në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë për zgjedhjet parlamentare.
5. Procesi i votimit zhvillohet në një ditë të vetme në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. KQZ-ja përcakton orën e hapjes dhe mbylljes së votimit në të gjithë vendin dhe modalitetet e tjera të votimit.
6. Votuesit shprehen vetëm për një nga alternativat që përmban fleta e votimit, të dhëna në variantin “Po” ose “Jo”, apo në variantin “Pro” ose “Kundër”.
7. Nëse në të njëjtën ditë organizohet më shumë se një referendum, atëherë fletët e votimit për secilin prej tyre duhet të kenë ngjyra të ndryshme.
8. Në votimin për referendumin, përdoret një kuti e veçantë për çdo çështje që është shtruar për votim. Kutia duhet të përmbajë shenja të qarta dalluese të nismës referendare të cilës i përket.
9. KQZ-ja përcakton formën tip të fletës së votimit si dhe shpëndan dhe bën publike modelin se si duhet plotësuar fleta e votimit.
10. Në mbyllje të procesit të votimit, bëhet numërimi i votave, referuar alternativave të paraqitura në fletën e votimit në referendum. Në këtë proces, numërohen të gjitha votat, duke nxjerrë totalin e votave për çdo alternativë të dhënë si dhe votat e pavlefshme.
11. KQZ-ja përcakton mënyrën e numërimit dhe dokumentimit të votave të vlefshme për çdo alternativë si dhe atyre që shpallen të pavlefshme, referuar këtij ligji dhe Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

### **Neni 33**

#### **Nxjerrja e rezultatit të referendunit**

1. Në përfundim të procesit të votimit, KQZ përpunon dhe bën publike të dhënat e mëposhtme:
  - a) numrin e votuesve të regjistruar në listat e votimit në referendum,
  - b) numrin e votuesve që kanë votuar në qendrat/vendet e votimit dhe jashtë tyre, përfshirë këtu edhe votimin elektronik,
  - c) numrin e votave në total, duke përcaktuar numrin e votave të vlefshme dhe atyre të pavlefshme,
  - ç) numrin e fletëve të votimit në total, numrin e fletëve të përdorura dhe atyre të papërdorura,
  - d) numrin e votave të vlefshme në favor të alternativës "Pro", ose "Po",

- dh) numrin e votave të vlefshme në favor të alternativës "Kundër", ose "Jo",  
e) numrin e votave të pavlefshme.
2. KQZ-ja në përfundim të procesit të votimit në referendum, dhe numërimit të votave, merr një nga vendimet e mëposhtme:
- a) miratimi nëpërmjet referendumit i çështjes së shtruar për referendum;
  - b) rrëzimi i çështjes së shtruar për referendum;
  - c) deklaron rezultatin e votimit si të pavlefshëm.
3. Drafti i paraqitur në referendum konsiderohet i miratuar nëse për të kanë votuar më shumë se ½ e votuesve që morën pjesë në referendum, por gjithsesi jo më pak se 1/3 e zgjedhësve në shkallë vendi.
4. Rezultatet e referendumit mund të kundërshtohen në Gjykatën Kushtetuese në përputhje me dispozitat përkatëse kushtetuese .

## **PJESA E DYTË**

### **KREU IV**

### **REFERENDUMI VENDOR**

#### **Neni 34.**

#### **Cështjet për të cilat mund të kërkohet referendum**

1. Qeverisja në njësitë e qeverisjes vendore ushtrohet edhe përmes referendumeve vendore, si formë dhe shprehje e demokracisë së drejtpërdrejtë.
2. Në referendumin vendor, banorët në juridiksionin e një apo më shumë njësive të qeverisjes vendore shprehin me votim, vullnetin e tyre për:
  - a) shpërndarjen e parakohshme të organit përfaqësues vendimarrës të njësisë të qeverisjes vendore;
  - b) shkarkimin e kryetarit të bashkisë;
  - c) riorganizimin e ndarjes administrativo-territoriale me ose pa ndryshim kufijsh të njësive të qeverisjes vendore [kerkohen inpute nga specialistet/partneret]
  - ç) mënyrën e zgjidhjes së çështjeve të një rëndësie të veçantë që prekin njësitet e qeverisjes vendore, të cilat përfshihen brenda kufijve, detyrave dhe kompetencave të organit përfaqësues vendimarrës të kësaj njësie;
  - d) vetëtaksimi i banorëve për qëllime publike, brenda kufijve të detyrave dhe kompetencave të organeve të njësive të qeverisjes vendore .

dh) çështje të tjera thelbësore, që iu referohen lidhjeve me natyrë shoqërore, ekonomike, apo kulturore që formojnë këtë njësi të qeverisjes vendore;
3. Referendumi vendor konsiston në dhënien e përgjigjes pozitive, apo negative në fletën zyrtare të votimit, për pyetjen, apo pyetjet që bëhen në lidhje me çështjet e përcaktuara paraprakisht që

të shtrohen për referendum, sipas parashikimeve të gërmave që përmban pika 2 e këtij neni, apo në përzgjedhjen e njërit prej varianteve të propozuara.

### **Neni 35**

#### **E drejta për të marrë pjesë**

Në referendum kanë të drejtë të marrin pjesë personat që banojnë në territorin e një njësie ose ose sipas rastit të disa njësive të qeverisjes vendore, që kanë mbushur moshën për të shtruar të drejtën aktive zgjedhore për organet e qeverisjes vendore.

### **Neni 36**

#### **Iniciuesi i referendumit**

1. Referendumi vendor mund të zhvillohet me nismën e organit përfaqësues vendimarrës të njësisë të së qeverisjes vendore dhe në këtë rast ai konsiderohet referendum nga lart-poshtë.
2. Kryetari i Bashkisë ka të drejtë t'i kërkojë Këshillit Bashkiak që një çështje të rëndësishme që ka impakt mbi qytetarët e NJQV që ai drejton, ta kalojnë për vendimarrje direkt në pupull përmes mekanizmit të referendumit vendor.
3. Referendumi vendor zhvillohet edhe me kërkesë të banorëve që jetojnë dhe janë të regjistruar në territorin juridiksional të NJQV, për një çështje që për ta paraqet rëndësi të veçantë.
4. Për çështjet që lidhen me shpërndarjen e parakohshme të organit përfaqësues të njësisë së qeverisjes vendore, si në rastin e kryetarit të bashkisë apo edhe në rastin e Këshillit Bashkiak/te Qarkut, vendoset vetëm me anë të referendumit që organizohet me nismën e qytetarëve ose organizatave të shoqërisë civile.
5. Për të legjitimuar një kërkesë referendare në nivel vendor nevojitet firma e të paktën:
  - 10 % të banorëve me të drejtë votimit të në nivel bashkie, sipas regjistrimit më të fundit në Rregjistrin e Gjendjes Civile që administrohet nga organi kompetent;
  - 5% të banorëve me të drejtë votimi në nivel Qarku, sipas regjistrimit më të fundit në Rregjistrin e Gjendjes Civile që administrohet nga organi kompetent;

[ kerkohen inpute ]

### **Neni 37**

#### **Afatet e depozitimit të kërkesës**

1. Kërkesa e qytetarëve, për organizimin e referendumit lidhur me shpërndarjen e parakohshme të organit përfaqësues dhe/ose me shkarkimin e organit ekzekutiv mund të depozitohet pasi të kenë kaluar 10 muaj nga fillimi i mandatit të organit të qeverisjes vendore, apo 10 muaj pas datës së referendumit të fundit të zhvilluar për të njëjtën çështje, por jo më vonë se 10 muaj përpara përfundimit të mandatit.

## **KREU V**

### **PROCEDURA E PËRGATITJES, ZHVILLIMIT, ADMINISTRIMIT DHE SHPALLJES SË REZULTATEVE SEKSIONI 1**

#### **REFERENDUMI I ZHVILLUAR ME NISMËN E ORGANIT PËRFAQËSUES TË NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE**

##### **Neni 38**

###### **Marrja e vendimeve për zhvillimin e referendunit**

1. Vendimi i këshillit të bashkisë për zhvillimin e referendunit merret me shumicën e votave, në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të këshillit [opsion: me shumicën absolute të votave të anëtarësisë së tij]
3. Vendimi, për mbajtjen e referendunit vendor përmban:
  - a) pyetjen, ose pyetjet e referendunit, apo variantet që i propozohen banorëve të njësive, për t'u zgjedhur prej tyre;
  - b) afatin e zhvillimit të referendunit;
  - c) modelin e fletës së votimit si dhe modelet e etiketave që ngjiten në fletën e votimit.;
  - ç) kalendarin e veprimeve në lidhje me zhvillimin e referendunit.
4. Në rastin, kur objekti i referendunit është vetë-taksimi i banorëve për qëllime publike, vendimi i organi përfaqësues tregon gjithashtu qëllimin, ose qëllimet si dhe parimet e vetëtaksimit.

##### **Neni 39**

###### **Publikimi i vendimit dhe afati i zhvillimit**

1. Vendimi i organit përfaqësues të njësisë së qeverisjes vendore lidhur me zhvillimin e referendunit publikohet zyrtarisht dhe krahas kësaj vendimi i organit përfaqësues afishohet menjëherë në formën e pllakateve dhe shpallet në mënyra të tjera, sipas normave/zakoneve të pranuar/njohura botërisht në njësinë e dhënë të qeverisjes vendore.
2. Referendumi zhvillohet në një ditë pushimi zyrtar dhe afati i fundit i zhvillimit të tij është 45 ditë nga dita e publikimit zyrtar të vendimit.

3. Nëse organi ekzekutiv i njësisë së qeverisjes vendore nxjerr një urdhëresë që konstaton pavlefshmërinë e vendimit në lidhje me zhvillimin e referendumit, në rastin e pranimit nga ana e gjykatës administrative të ankesës ndaj kësaj urdhërese, referendumi zhvillohet në një ditë pushimi zyrtar, jo më vonë se 45 ditë nga dita, kur vendimi i gjykatës administrative merr formë të prerë.

4. Në rastin e parashikuar në paragrafin 3, organi përfaqësues i njësisë së qeverisjes vendore, merr vendimin në lidhje me përditësimin e kalendarit të veprimeve, të parashikuara në nenin 29, paragrafi 2 gërma ç.

## **SEKSIONI 2**

### **REFERENDUMIN QË ZHVILLOHET ME NISMËN E BANORËVE TË NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE**

#### **Neni 40**

##### **Grupi nismëtar**

1. Nismën e zhvillimit të referendumit me kërkesë të banorëve të njësisë së qeverisjes vendore, e kanë:

- a) të paktën 15 shtetas shqiptar me të drejtë vote (grupi nismëtar), të cilët gëzojnë të drejtën për tu zgjedhur në organet drejtuese të njësisë së qeverisjes vendore;
- b) një organizatë e shoqërisë civie që ka personalitet juridik, veprimtaria aktive e të cilës, sipas statutit të saj, është e shtrirë të paktën në territorin e njësisë të dhënë të qeverisjes vendore, përfaqësuesit e të cilës gëzojnë të drejtën për tu zgjedhur në organet drejtuese të njësisë së qeverisjes vendore.

#### **Neni 41**

##### **Kërkesat dhe përmbajtja e tyre**

1. Grupi nismëtar i drejtohet me kërkesë me shkrim organit përfaqësues dhe organit ekzekutiv me synimin e zhvillimit të referendumit.

2. Kërkesa përmban:

- a) nëse grupi nismëtar është një grup qytetarësh – emrat, mbiemrat, adresat e vendbanimit si dhe numrat e kartave të identitetit të anëtarëve të grupit. ;
- b) nëse grupi nismëtar është një organizatë e shoqërisë civile, njoftimi përmban emërtimin e Nismëtarit, adresën e selisë si dhe emrin, mbiemrin, adresën e vendbanimit si dhe numrin kartës të identitetit të personit që është përfaqësuesi i saj, ndërsa njoftimit i bashkëlidhet

një kopje e vendimit të regjistrimit të organizatës.; Përfaqësuesi mund të jetë vetëm personi, të cilit i takon e drejta e zgjedhjes në organet drejtues të njësisë së caktuar të qeverisjes vendore.

c) përcaktimi i çështjes, e cila do të shtrohet në referendum, ndërsa, kur kërkesa lidhet me referendumin për çështjen e vetëtaksimit, edhe qëllimin, apo qëllimet si dhe parimet e vetëtaksimit.

3. Organi përfaqësues dhe organi ekzekutiv konfirmon me shkrim brenda 48 orëve, marrjen e kërkesës.

4. Grupi nismëtar me kërkesë me shkrim drejtuar organeve drejtuese të njësisë së qeverisjes vendore kërkon numrin zyrtar të banorëve të njësisë së pushtetit vendor me të drejtë votimi, të përfshirë në regjistrim e zgjedhësve të njësisë.

5. Kryetari i këshillit të njësisë së qeverisjes vendor, dhe në rastin e bashkisë, kryetari i bashkisë, brenda 10 ditësh nga marrja e kërkesës njofton me shkrim, grupin nismëtar të referendunit, apo përfaqësuesin e tij mbi numrin e banorëve të njësisë së pushtetit vendor me të drejtë votimi, të përfshirë në regjistrim e zgjedhësve në bashki, në përfundim të tremujorit që paraprin tremujorin në të cilin është dorëzuar kërkesa. Këtë numër në rang qarku dhe prefekturë e përcakton dhe ia përcjell menjëherë kryetarëve të këshillave përkatës (të qarkut dhe prefekturës) KQZ, bazuar në raportimet mbi gjendjen e regjistrimit të zgjedhësve të dorëzuara prej kryetarëve të bashkive deri në ditën e 10 të muajit që pason pas mbylljes së tremujorit.

6. Nismëtari i referendunit në çështjen që lidhet me shkrirjen e parakohshme të organit përfaqësues apo për shkarkimin e organit ekzekutiv të njësisë së qeverisjes vendore përpara mbarimit të mandatit njofton për synimin, për të dalë me këtë nismë, edhe KQZ; në lidhje me këtë njoftim zbatohen, dispozitat e paragrafeve 1-3.

## **Neni 42**

### **Publikimi i nismës**

1. Grupi nismëtar i referendunit vë në dijeni banorët e njësisë së qeverisjes vendore, për objektin e referendunit që synon, duke pasur parasysh që vënia në dijeni në bashki ndodh sipas zakoneve të pranura gjerësisht, ndërsa në rang qarku nëpërmjet shpalljes në median e përditshme me akses të gjerë në njësinë e dhënë të pushtetit vendor. Grupi nismëtar mund të kërkojë nga Këshilli Bashkiak që, për efekt të njoftimit të nismës, ai të shprehet me vendim për të alokuar burime financiare nga fondi rezerve. Grupi nismëtar mund të zgjedhe të përballojë vetë shpenzimet për njoftimin e nismës referendare.

2. Informacioni për referendumin duhet të përmbajë pyetjen, ose pyetjet e referendunit, apo variantet e propozuara për t'u përzgjedhur, ndërsa, kur kërkesa ka lidhje me referendumin e vetëtaksimit, edhe qëllimin, apo qëllimet si dhe parimet e vetëtaksimit.
3. Informacioni për referendumin e synuar në lidhje me shkirjen e parakohshme të organit përfaqësues apo të shkarkimit të organit ekzekutiv para mbarimit të mandatit të qeverisjes vendore përmban dhe arsyetimin e shkirjes apo shkarkimit.

### **Neni 43**

#### **Mbledhja e nënshkrimeve dhe format i nevojshëm**

1. Periudha për mbledhjen e nënshkrimeve është 3 muaj nga nga dita e njoftimit, grupi nismëtar, mbledh nënshkrimet e banorëve që kanë të drejtën e zgjedhjes në organet drejtuese të njësisë së qeverisjes vendore, të cilët dëshirojnë të mbështesin nismën për këtë çështje.
2. Format i që përdoret në këtë rast, për mbledhjen e nënshkrimeve duhet të përmbajë:
  - a) çështjen që shtrohet për referendum
  - b) numrin rendor,
  - c) emrin dhe mbiemrin e votuesit,
  - ç) numrin e kartës së identitetit apo pasaportës,
  - d) datëlindjen,
  - dh) vendlindjen dhe vendbanimin,
  - e) nënshkrimin dhe datën.
3. Tërheqja e mbështetjes së dhënë nuk prodhon efekte.

### **Neni 44**

#### **Shkatërrimi i fletëve**

1. Në rastin e mosdorëzimit të kërkesës për zhvillimin e referendunit, grupi nismëtar i tij kryen me protokoll, shkatërrimin e fletëve.
2. Shkatërrimi i fletëve bëhet jo më vonë se pas 3 ditësh nga kalimi i afatit për të cilin flitet në nenin 34, pika 1.
3. Protokollin që vërteton shkatërrimin e fletëve, grupi nismëtar i referendunit ia përcjell menjëherë organit përfaqësues të njësisë së qeverisjes vendore. ndërsa në rastin e zhvillimit të referendunit në lidhje me shkirjen e parakohshme të organit përfaqësues apo për shkarkimin e organit ekzekutiv të njësisë së qeverisjes vendore përpara mbarimit të mandatit Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.



### **SEKSIONI 3**

#### **REFERENDUMI ME KËRKESË TË BANORËVE NË NJË ÇËSHTJE TJETËR NGA SHKARKIMI I ORGANIT TË NJËSISË SË PUSHTETIT VENDOR**

##### **Neni 45**

##### **Paraqitja e kërkesës dhe përmbajtja**

1. Grupi nismëtar i referendunit ia përcjell kërkesën për zhvillimin e referendunit, kryetarit të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore, ndërsa në bashki, kryetarit të bashkisë të cilët konfirmojnë me shkrim marrjen e kërkesës jo më vonë se 3 ditë nga disponimi i saj.
2. Kërkesa për zhvillimin e referendunit duhet të përmbajë pyetjen, apo pyetjet e referendunit, ose variantet e propozuara për përzgjedhje, ndërsa, kur kërkesa lidhet me referendumin për çështjen e vetëtaksimit, edhe qëllimin, apo qëllimet si dhe parimet e vetëtaksimit.

##### **Neni 46**

##### **Ngritja e komisionit dhe trajtimi i kërkesave**

1. Organi përfaqësues i njësisë së qeverisjes vendore cakton nga anëtarët e tij përbërjen e komisionit për verifikimin, nëse kërkesa e banorëve për zhvillimin e referendunit është në përputhje me kërkesat e ligjit.
2. Për pjesëmarrjen në punimet e komisionit në cilësinë e vëzhguesit, ftohet një nga antarët e grupit nismëtar të referendunit, ose përfaqësuesi i tij në rastin e organizatave të shoqërisë civile Anëtari i grupit nismëtar, ose përfaqësuesi i tij, në rastin e organizatave të shoqërisë civile, në rast nevojë, por edhe me nismë të vet, mund t'i paraqesë komisionit shpjegime shtesë dhe të dorëzojë prova.
3. Kërkesën për zhvillimin e referendunit që nuk i përmbahet kërkesave të nenit 45 paragrafi 2, komisioni ia kthen mbrapsht nismëtarit të referendunit, duke i caktuar një afat katërmëdhjetë ditor për të plotësuar mangësitë.
4. Nëse komisioni konstaton se kërkesa për zhvillimin e referendunit përmban mangësi, të cilat nuk mund të plotësohen, ia përcjell kërkesën organit drejtues të njësisë së qeverisjes vendore së bashku me opinionin e vet.
5. Dispozita e pikës 4 nuk zbatohet në rastin kur mangësitë e kërkesës konsistojnë në mbledhjen e një numri të pamjaftueshëm nënshkrimesh të hedhura rregullisht nga personat që e mbështesin kërkesën.

##### **Neni 47**

##### **Marrja e vendimit për zhvillimin e referendunit**

1. Organi drejtues i njësisë së qeverisjes vendore merr vendimin për zhvillimin e referendunit, nëse kërkesa e banorëve është në përputhje me kriteret e këtij ligji si dhe nuk shpie në zgjidhje që janë në kundërshtim me ligjin.
2. Në rastin e dorëzimit të dy, ose më shumë kërkesave për zhvillim referendumi, organi vendimarrës i njësisë së qeverisjes vendore, merr vendimin për zhvillimin e referendumeve, sipas radhës, në të cilën janë paraqitur kërkesat nga ana e grupit nismëtar të referendumeve apo nga përfaqësuesit. Organi vendimarrës mundet, gjithashtu, nëse kjo është e mundur, t'i kalojë njëherazi për referendum të gjitha kërkesat apo një pjesë të tyre.

#### **Neni 48**

##### **Afati për marrjen e vendimeve për zhvillimin e referendunit**

Organi vendimarrës i njësisë së qeverisjes vendore merr vendimin për zhvillimin e referendunit ose vendimin për rrëzimin e kërkesës së banorëve jo më vonë se 30 ditë nga dita kur kërkesa i është paraqitur.

#### **Neni 49**

##### **Publikimi i vendimit për referendum**

1. Vendimi i organit vendimarrës të njësisë së qeverisjes vendore lidhur me zhvillimin e referendunit me kërkesë të banorëve publikohet zyrtarisht në faqen zyrtare të Bashkisë, qarkut si dhe komunikohet për të paktën një javë rrjesht në media.
2. Vendimi i organit përfaqësues (këshilli bashkiak ose Këshilli i qarkut) për zhvillimin e referendunit hyn në fuqi komform dispozitave që përmban ligji 139/2015

#### **Neni 50**

##### **Ankimi ndaj Vendimit të organit drejtues**

1. Ndaj vendimit të organit vendimarrës të njësisë së qeverisjes vendore, që rrëzon kërkesën e banorëve për zhvillimin e referendunit, si dhe për mosrespektim të afatit të marrjes së vendimit, grupit nismëtar për referendumin i lind e drejta të bëjë ankesë në gjykatën kompetente brenda një afati prej 30 ditësh nga shpallja e marrjes së vendimit refuzues
2. Gjykata kompetente e shqyrton kërkesën brenda afateve ligjore të përcaktuar në ligjin e saj organik ose në Kodin Zgjedhor të RSH.
3. Vendimi i formës së prerë i gjykatës, që e pranon kërkesën, zëvendëson vendimin e organit vendimarrës të njësisë së qeverisjes vendore.

4. Në bazë të vendimit të përmendur në paragrafin 3, njësia e qeverisjes vendore në rakordim me KQZ, merr vendim për zhvillimin e referendumit duke ndjekur hapat proceduralë që cakton ky ligj dhe/ose Kodi Zgjedhor

## **Neni 51**

### **Caktimi i datës dhe ditës të zhvillimit të referendumit**

Referendumi zhvillohet në një ditë pushimi zyrtar, jo më vonë se 45 ditë nga:

- 1) dita e publikimit zyrtar të vendimit të organit endimarrës të njësisë së qeverisjes vendore për këtë çështje.
- 2) dita kur vendimi i gjykatës që lëjon zhvillimin e një referendumit vendor merr formë të prerë.
- 3) data e mbajtjes së referendumit përcaktohet nga organi përfaqësues i njësisë së qeverisjes vendore në rakordim me KQZ.

## **SEKSIONI 4**

### **REFERENDUMI PËR SHKRIRJEN E PARAKOHSHME APO SHKARKIMIN E ORGANIT TË NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE**

## **Neni 52**

### **Ndërmarrja e nismës dhe shqyrtimi nga KQZ**

1. Grupi nismëtar i referendumit për shkrirjen e parakohshme të organit përfaqësues vendimarrës apo për shkarkimin e organit ekzekutiv të njësisë së qeverisjes vendore përpara mbarimit të mandatit i përcjell me shkrim KQZ, në afatin e përcaktuar në këtë ligj, kërkesën e banorëve, së bashku me informacionin e domosdoshmë që duhet të përmbajë kërkesa për referendum vendor. KQZ ka detyrimin të konfirmojë zyrtarisht me shkrim jo më vonë se 48 orë marrjen e kërkesës prej dërguesit (organit përfaqësues, grupit nismëtar).

3. KQZ i kthen zyrtarisht grupit nismëtar të referendumit, ose përfaqësuesit të tij, kërkesën nëse konstaton mangësi në të dhe i cakton një afat prej 15 ditësh për plotësimin e tyre.

4. KQZ e rrëzon kërkesën për zhvillimin e referendumit, në rastin kur konstaton se ai përmban mangësi që nuk është e mundur të plotësohen, si dhe nëse nismëtari i referendumit nuk i ka përmbushur detyrimet e parashikuara në Pjesën 2 të këtij ligj. Vendimi për rrëzimin e kërkesës i përcillet menjëherë grupit nismëtar të referendumit, ose përfaqësuesit të tij.

5. Dispozitat e paragrafit 3 nuk zbatohen, në rastin kur mangësitë e kërkesës konsistojnë në mbledhjen e një numri të pamjaftueshëm nënshkrimesh nga ana e personave që e mbështesin kërkesën, me përjashtim të rastit, kur nuk ka kaluar ende afati brenda të cilit mund të paraqitet një kërkesë për referendum vendor.

6. Grupi nismëtar i referendumit vendor, ose përfaqësuesi i tij, në rast nevoje, edhe me nismën e vet, mund t'i japë KQZ shpjegime shtesë dhe t'i paraqesë prova. KQZ mund të kërkojë nga grupi nismëtar i referendumit ose nga përfaqësuesi i tij dhënien e shpjegimeve të tilla, ose paraqitjen e provave.

### **Neni 53**

#### **Marrja e vendimit nga KQZ për zhvillimin e referendumit**

1. KQZ vendos për zhvillimin e referendumit me nismë të banorëve, nëse kërkesa e banorëve i plotëson kriteret e përcaktuara në këtë ligj.
2. Në rastin kur paraqiten dy ose më shumë kërkesa, sipas parashikimit të paragrafit 1 KQZ vendos për zhvillimin e referendumit në afatin, që llogaritet nga dita e marrjes së kërkesës së parë.

### **Neni 54**

#### **Afatet për marrjen e vendimit nga KQZ**

1. KQZ vendos për zhvillimin e referendumit, ose për rrëzimin e kërkesës së banorëve, jo më vonë se 30 ditë nga dita e paraqitjes së saj.

### **Neni 55**

#### **Depozitimi i vendimit të organi përfaqësues në KQZ**

1. Vendimin e këshillit bashkiak për mbajtjen e referendumit për shkarkimin e kryetarit të bashkisë, kryetari i këshillit të bashkisë ia përcjell KQZ zyrtarisht, pasi të këtë marrë më parë konfirmimin nga prefekti.
2. Prefekti vlerëson ligjshmërinë e vendimarrjes bazuar në Ligjin 135/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” si dhe në dispozitat e këtij ligji. Prefekti nuk autorizohet të bëjë verësim të ligjshmërisë bazuar në dispozitat e Kodit Zgjedhor.
3. Në rast të mos-konfirmimit nga Prefekti, organi vendimarrës në nivel të qeverisjes vendore ka të drejtë të atakojë në gjykatën administrative të rrethit gjyqësor kompetent aktin e Prefektit.

### **Neni 56**

## **Marrja e vendimit nga KQZ për zhvillimin e referendumit për te dy organet e qeverisë vendore**

Në rastin kur paraqiten dy, ose më shumë kërkesa të banorëve për zhvillimin e referendumit për shkarkimin e organeve të bashkisë si dhe vendimi i këshillit të bashkisë për zhvillimin e referendumit për shkarkimin e kryetarit të bashkisë, KQZ vendos për mbajtjen e referendumit në një afat që llogaritet nga data e marrjes së kërkesë, apo vendimit të parë.

### **Neni 57**

#### **Përmbajtja e vendimit të KQZ për zhvillimin e referendumit**

1. Vendimi i KQZ për zhvillimin e referendumit përmban:
  - a) afatin e zhvillimit të referendumit;
  - b) modelin dhe përmbajtjen e fletës së votimit;
  - c) kalendarin e veprimeve që lidhen me zhvillimin e referendumit.
2. Vendimi, për të cilin flitet në paragrafin 1, publikohet në përputhje me nenin 30, paragrafi 1.

### **Neni 58**

#### **Ankimi ndaj vendimit të KQZ**

1. Ndaj vendimit të KQZ, që rrëzon kërkesën për zhvillimin e një referendumi vendor si dhe në rastin e mosrespektimit nga ana e KQZ të afatit të përcaktuar në këtë kre për administrimin e kërkesës, nismëtarit të referendumit i lind e drejta të bëjë ankesë në Kolegjin Zgjedhor brenda 5 ditësh nga data e dorëzimit të vendimit.
2. Kolegji Zgjedhor e shqyrton ankesën brenda 10 ditëve nga dita e paraqitjes së ankesës.
3. Bazuar në vendimin që e pranon ankesën, KQZ vendos për zhvillimin e referendumit.

### **Neni 59**

#### **Afati për zhvillimin e referendumit**

Referendumi zhvillohet në një ditë pushimi zyrtar, dhe jo më vonë se 45 ditë, nga dita e publikimit të vendimit për këtë çështje, ose nga dita kur vendimi i gjykatës administrative ka marrë formë të prerë.

### **Neni 60.**

#### **Fushata e referendumit**

1. Fushata e referendumit synon të lehtësojë shpjegimin nga ana e organit të njësisë së qeverisjes vendore, i cili ka vendosur për zhvillimin e referendumit, thelbin e problemeve që

do të shqyrtohen me referendum, përmbajtjen e pyetjeve, apo varianteve të propozuara, si dhe qëndrimin e grupit nismëtar të referendumit lidhur me çështjen e shtruar për referendum.

2. Fushata e referendumit nis në ditën e miratimit të vendimit nga ana e organit drejtues të njësisë së qeverisjes vendore në rakordim me KQZ për mbajtjen e referendumit dhe mbyllet 24 orë përpara ditës së votimit.

3. Nga përfundimi i fushatës së referendumit, deri në përfundim të votimit, ndalohet çdo thirrje për tubime, organizimi i parakalimeve dhe manifestimeve, fjalimet publike, shpërndarja e fletëpalosjeve si dhe zhvillimi në ndonjë mënyrë tjetër i agjitacionit që lidhet me referendumin.

## **Neni 61**

### **Ndalimi i publikimit të rezultateve**

Gjatë 24 orëve përpara ditës së mbajtjes së referendumit, e deri në përfundimin e votimit, ndalohet publikimi i rezultateve të hulumtimeve të opinionit publik, që lidhen me sjelljet e parashikuara të banorëve në referendum si dhe i rezultateve të referendumit apo i sondazheve që zhvillohen në ditën e referendumit [*exit polls*].

## **Neni 62**

### **Mbrojtia e materialeve propogantistik dhe heqja e tyre**

Të gjitha pllakatet, parullat dhe fletëpalosjet që lidhen me referendumin, e që tregojnë hapur se nga kush vijnë, apo që konstatojnë, se kush është shpërndarësi i tyre, mbrohen me ligj.

5. Subjektet, që marrin pjesë në fushatën e referendumit janë të detyruara që të heqin pllakatet dhe parullat referendare që vijnë prej tyre, si dhe pajisjet që afishojnë shpalljet, brenda 30 ditëve nga dita e referendumit.

6. Kryetari i bashkisë vendos për heqjen e pllakateve dhe të parullave referendare si dhe të pajisjeve që afishojnë shpalljet, që nuk janë hequr nga subjekti i detyruar për ta bërë këtë, sipas parashikimit të paragrafit 5. Shpenzimet e lidhur me heqjen e tyre i ngarkohen subjekteve të detyruara.

## **Neni 63**

### **Mbrojtia ndaj progandës së rreme**

1. Nëse pllakatet, parullat, fletëpalosjet, shprehjet, apo format e tjera të propagandës dhe agjitacionit përmbajnë të dhëna dhe informacione të rreme, çdo i interesuar ka të drejtë, që të kërkojë në gjykatën e rrethit:

- 1) konfiskimin e këtyre materialeve;
- 2) ndalimin e publikimit e këtyre materialeve;

- 3) urdhërimin e përgënjeshtimit të informacionit;
- 4) urdhërimin, t'i kërkohet ndjesë personit të përfolur;
- 5) detyrimin e pjesëmarrësit në proces, që të paguajë një shumë prej \_\_\_\_\_ në favor të një institucioni bamirësie.
- 6) detyrimin e pjesëmarrësit në proces, që të paguajë për llogari të kërkuesit një shumë prej \_\_\_\_\_ në formë dëmshpërblimi.

#### **Neni 64**

#### **Dispozitat ligjore për mbrojtjen e të drejtave të personave të dëmtuar**

Realizimi i të drejtave që burojnë nga dispozitat e ligjit nuk bëhet pengesë për mundësinë e realizimit nga ana e personave të dëmtuar, të të drejtave sipas dispozitave të ligjeve të vecanta, në vecanti, sipas Kodit Penal, Kodit Civil dhe Ligjit për Shtypin, ndaj atyre personave, veprimi, ose mosveprimi i të cilëve gjatë ecurisë së fushatës për referendumin ka cënuar të mirat personale, ose pasurore të të tjerëve.

### **KREU VI**

#### **MËNYRA E ZHVILLIMIT TË REFERENDUMIT VENDOR DHE SHPALLJA E REZULTATEVE**

#### **Neni 65**

#### **Ngritja e komisioneve vendore dhe zonale**

1. Për zhvillimin, administrimin dhe shpalljen e rezultatit të referendumeve, ngrihen komisione të posaçme, të cilat do të quhen më tej „komisione vendore” dhe „komisione zonale”.
2. Komisionin vendor e krijon, jo më vonë se 25 ditë përpara ditës së referendumit:
  - a) KQZ, në rastin e referendumit, shkrirjes së parakohshëm të organit përfaqësues apo për shkarkimin e organit ekzekutiv të njësisë së qeverisjes vendore përpara mbarimit të mandatit;
  - b) organi drejtues i njësisë së qeverisjes vendore, për çështjet e tjera
3. Komisionet zonale i krijon, jo më vonë se 21 ditë përpara ditës së referendumit:
  - a) KQZ në rastin e referendumit, shkrirjes së parakohshëm të organit përfaqësues apo për shkarkimin e organit ekzekutiv të njësisë së qeverisjes vendore përpara mbarimit të mandatit;
  - b) komisioni vendor, për çështjet e tjera.

4. Komisionet vendore dhe zonale kanë vulën e tyre, modelin e së cilës e përcakton Komisioni Qendror Zgjedhor.

5. Përsa u takon parimeve të veprimtarisë së komisioneve vendore dhe zonale zbatohen respektivisht, dispozitat e Kodit Zgjedhor që lidhen me komisionin e zonave të administrimit zgjedhor (KZAZ) dhe komisionet e qendrës së votimit (KQV).

#### **Neni 66**

##### **Përbërja, ndryshimi apo plotësimi e komisioneve**

1. KQZ i krijon komisionet vendore dhe zonale për zhvillimin e referendumit për shkrirjen e parakohshme të organit përfaqësues apo për shkarkimin e organit ekzekutiv të njësisë së qeverisjes vendore përpara mbarimit të mandatit, me numër të barabartë anëtarësh, nga radhët e personave që propozohen me shkrim nga organi ekzekutiv i kësaj njësie si dhe nga nismëtari i referendumit.

2. Në përbërje të komisionit nuk mund të hyjnë këshilltarët, personat që janë anëtarë, apo ushtrojnë funksionin e organit ekzekutiv të njësisë së pushtetit vendor, apo nismëtari i referendumit dhe përfaqësuesi i tij.

#### **Neni 67**

##### **Caktimi i vëzhguesve**

Organi ekzekutiv i njësisë së qeverisjes vendore si dhe grupi nismëtar i referendumit mund t'i caktojnë komisionit vendor si dhe secilit komision zonal nga një vëzhgues të pavarur, i cili ka të drejtën të jetë i pranishëm në të gjitha veprimet e kryera nga këto komisione si dhe të bëjë vërejtje të protokolluara në protokollin e rezultateve të votimit si dhe rezulteteve të referendumit, së bashku me pretendimet konkrete.

#### **Neni 68**

##### **Shtypshkrimi i fletëve të votimit**

1. Komisioni vendor urdhëron shtypshkrimin e numrit të nevojshëm të fletëve të votimit dhe siguron pajisjen me to të komisioneve zonale, konform parashikimeve procedurale që përmban Kodi Zgjedhor

2. Në referendumin për shkrirjen e parakohshme të organit përfaqësues apo për shkarkimin e organit ekzekutiv të njësisë së qeverisjes vendore përpara mbarimit të mandatit, KQZ urdhëron shtypshkrimin e fletëve të votimit si dhe përcakton mënyrën e administrimit të tyre nga komisionet/komisioneret.



## **Neni 69**

### **Përmbajtja e fletës së votimit**

1. Fleta e votimit përmban:

a) emërtimin e referendumit, emërtimin e organit apo të grupit nismëtar, i cili ka vendosur zhvillimin e referendumit, datën e referendumit;

b) pyetjen ose pyetjet apo variante të propozuara për çështjen që është objekt i referendumit; nëse referendumi konsiston në përgjigjen ndaj pyetjeve të shtruara, në fletën e votimit vendosen gjithashtu edhe shprehjet „po” dhe „jo” me kuadrate në krahun e majtë, ku do të vendoset edhe shenja e përgjigjes të cilën zgjedh votuesi, ndërsa, kur referendumi konsiston në përzgjedhjen nga votuesi të njërit prej varianteve të propozuara, në krah të majtë të çdonjërit prej varianteve vendoset numri i variantit dhe kuadrati për vendosjen e shenjës, nëse votuesi është pro atij varianti.

c) udhëzimi lidhur me mënyrën e votimit.

2. Në rast të mbajtjes së referendumit për më shumë se një çështje, në fletën e votimit vendosen me radhë të gjitha pyetjet, apo variantet e shtruara, duke respektuar kërkesat e parashikuara në paragrafin 1, gërma a dhe b.

3. Fleta e votimit mund të shtypet vetëm nga njëra faqe.

4. Në fletën e votimit shtypet edhe një shenjë e vulës së organit kompetent për marrjen e vendimit për zhvillimin e referendumit.

5. Në çastin kur e jep fletën e votimit, komisioni vendor e vulos atë me vulën e vet.

## **Neni 70**

### **Mënyra e caktimit të zonës dhe vendndodhjes së qendrës së votimit**

1. Për caktimin e zonës dhe vendndodhjes së qendrës së votimit zbatohen dispozitat e Kodit Zgjedhor.

## **Neni 71**

### **Vlefshmëria e referendumeve**

1. Referendumi është i vlefshëm, nëse në të ka marrë pjesë të paktën 30% e personave me të drejtë vote.

2. Referendumi për shkrirjen e parakohshme të organit përfaqësues apo për shkarkimin e organit ekzekutiv të njësisë së qeverisjes vendore përpara mbarimit të mandatit, që është mandatuar nga zgjedhjet e drejtpërdrejta është i vlefshëm, nëse në të merr pjesë jo më pak se 3/5 e numrit të atyre që kanë marrë pjesë në zgjedhjen e organit të shkrirë apo të shkarkuar.

## **Neni 72**

### **Rezultati**

1. Rezultati i referendumit është pozitiv, kur në favor të njëjës prej alternativave të propozuara për çështjen e parashtruar në referendum, është dhënë më shumë se gjysma e votave të vlefshme.
2. Rezultati i referendumit në rang bashkie për vetëtaksimin e banorëve për qëllime publike është pozitiv, nëse në favor të vetëtaksimit janë dhënë më shumë se 2/3 e votave të vlefshme.

## **Neni 73**

### **Pavlefshmëria**

1. Vota është e pavlefshme, nëse në fletën e votimit, nuk është vendosur asnjë përgjigje në lidhje me pyetjen apo variantin të parashtruar apo nuk është zgjedhur asnjë prej varianteve.
2. Vota është e pavlefshme në lidhje me një pyetje, apo variant të caktuar nëse në fletën e votimit është dhënë më shumë se një përgjigje për pyetjen, apo është përzgjedhur më shumë se një prej varianteve.

## **Neni 74**

### **Pavlefshmëria e fletës së votimit**

1. Janë të pavlefshme fletët e votimit të ndryshme nga ato të përcaktuara zyrtarisht dhe që nuk janë pajisur me vulën e komisionit zonal.
2. Shkrimi i vërejtjeve apo i shënimeve të tjera jashtë kuadrantit nuk ndikon në vlefshmërinë e fletës së votimit.
3. Fletët e votimit të grisura tërësisht, në dy, ose më shumë pjesë nuk merren parasysh në përlogaritjen e rezultatit të votimit.

## **Neni 75**

### **Plotësimi i protokollit nga komisioni zonal**

1. Pas përfundimit të votimit, komisioni zonal harton në tre ekzemplarë, protokollin e rezultateve të votimit në zonë, i cili përmban numrin e:
  - a) personave me të drejtë votimi;
  - b) personave që iu është dhënë një fletë votimi;

- c) fletët e votimit të nxjerra nga kutitë e votimit;
  - ç) fletët e pavlefshme të votimit;
  - d) fletët e vlefshme, që do të thotë numri i atyre që morën pjesë në votim;
  - dh) votat e pavlefshme;
  - e) votat e vlefshme;
  - ë) votat e vlefshme që janë dhënë ndaj përgjigjeve të caktuara për pyetjet e bëra apo që janë dhënë në favor të një varianti të caktuar.
2. Në rastin e mbajtjes së referendumit për më shumë se një çështje, shifrat për të cilat flet paragrafi 1, gërmat (dh) dhe (ë), komisioni i shënon në protokoll, veçmas për secilën pyetje, apo variant.
  3. Protokollin firmoset në çdo faqe dhe nënshkruhet me emër, mbiemër dhe firmë në fund nga të gjithë personat që janë anëtarë të komisionit, e që janë të pranishëm në hartimin e tij. Protokollin pajiset me vulën e komisionit.
  4. Anëtarëve të komisionit dhe vëzhguesve të pavarur iu lind e drejta të bëjnë vërejtje, të cilat shënohen në protokoll së bashku me pretendime konkrete.
  5. Pas hartimit të protokollit, komisioni zonal bën menjëherë publike rezultatet e votimit me anë të afishimit në selinë e tij, në një vend lehtësisht të aksesueshëm për shtetasit të një prej protokolleve të votimit në zonë.
  6. Kryetari i komisionit zonal i përcjell komisionit vendor (në referendumin në rang prefekturë – komisionit të qarkut, për të cilin flitet në nenin 69) të mbyllur në zarf të vulosur, një ekzemplar të protokollit të votimit në zonë.

## **Neni 76**

### **Depozitimi i materialeve zgjedhore**

Pas kryerje së veprimit të përmendur në nenin 66, paragrafet 5 dhe 6, kryetarët e komisioneve zonale, i kalojnë menjëherë për ruajtje kryetarit të bashkisë dokumentet e votimit, në pako të vulosura së bashku me vulën e komisionit.

## **Neni 77**

### **Përpunimi i të dhënave nga komisioni vendor**

1. Menjëherë pas marrjes së protokollit të votimit nga të gjitha komisionet zonale, komisioni vendor harton në katër ekzemplare protokollin e rezultateve të referendumit, i cili përmban:

- 1) të dhënat shifrore të përmbledhura (agregate), të përmendura në nenin 66 paragrafi 1, nga i gjithë territori i njësisë së pushtetit vendor.
- 2) rezultatin e referendumit.
2. Dispozitat e nenit 66 paragrafet 2–5 zbatohen edhe në këtë rast.
3. Pas kryerjes së veprimit, të përmendur në nenin 1, komisioni vendor ia kalon kryetarit të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore, ndërsa në bashki, kryetarit të bashkisë, dokumentet e komisionit së bashku me vulën.

## **Neni 78**

### **Komisionet e qarkut dhe roli i tyre**

1. Me qëllim zhvillimin e referendumit në rang qarku, organet e përmendura në nenin 56, paragrafi 2, brenda juridiksionit të tyre territorial, ngrenë komisionet e qarkut që veprojnë si organe ndihmëse për përcaktimin e rezultateve të agreguara të votimit në zonat, që gjenden në territorin e qarkut. Dispozitat e neneve 57 dhe 59 gjejnë zbatim sipas rastit, por, me ndryshimin e vetëm, që komisionet e qarqeve kanë nga 6 deri në 10 anëtarë.
2. Komisioni i qarkut, menjëherë pas marrjes së protokolleve të votimit nga të gjitha komisionet zonale nga territori i qarkut, harton protokollin të rezultateve të përmbledhura të votimit në territorin e qarkut, i cili përmban:
  - 1) të dhënat e përmbledhura shifrore të përmendura në nenin 66, paragrafi 1, në territorin e qarkut;
  - 2) rezultatin e referendumit.
3. Për veprimin e komisioneve të qarkut, të përmendura në paragrafin 1, zbatohen dispozitat e nenit 66, paragrafet 2-5 dhe të nenit 68, paragrafi 3.

## **Neni 79**

### **Shpallja e rezultatit të votimit**

1. Menjëherë pas hartimit të protokollit të rezultatit të referendumit, komisioni vendor bën publike rezultatet e votimit dhe rezultatin e referendumit përmes afishimit në selinë e saj të një ekzemplari të këtij protokollit.
2. Prefekti shpall menjëherë në rrugë zyrtare rezultatin e referendumit të marrë nga komisioni vendor.

3. Nëse referendumi është zhvilluar nga organi drejtues i njësisë së pushtetit vendor, një ekzemplar i protokollit të rezultatit të referendumit së bashku me protokollet e komisionit vendor dhe të komisioneve zonale, komisioni vendor menjëherë ia përcjell kryetarit të bashkisë apo kryetarit të këshillit të qarkut.

4. Nëse referendumi lidhet me shkrirjen e parakohshme të organit përfaqësues apo për shkarkimin e organit ekzekutiv të njësisë së qeverisjes vendore përpara mbarimit të mandatit, komisioni vendor menjëherë ia përcjell protokollin e referendumit, së bashku me protokollet e komisioneve zonale KQZ-së.

5. Në rastin e referendumit, për të cilin flitet në paragrafin 4, njërin nga ekzemplarët e protokollit, komisioni vendor ia përcjell menjëherë edhe prefektit.

## **Neni 80**

### **Përcaktimi i modeleve të formularëve zyrtarë të protokolleve**

Modelet e formularëve zyrtarë të protokolleve të përmendura në nenin, 66,68 dhe 69 dhe të hartuara nga komisionet vendore dhe zonale, përcaktohen nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

## **Neni 81**

### **Zbatimi në praktikë i rezultatit final të referendumit**

Nëse referendumi përfundon me rezultat pozitiv në çështjen e shtruar për referendum, organi kompetent i njësisë së pushtetit vendor merr menjëherë masat me qëllim zbatimin e tij.

## **Neni 82**

### **Pasojat e rezultatit të referendumit**

1. Shpallja e rezultateve të referendumit në favor të shkrirjes të parakohshme të organit përfaqësues dhe shkarkimit të organit ekzekutiv para mbarimit të mandatit nënkuptom përfundimin e veprimtarisë së këtyre organeve.
2. Shpallja e rezultateve të referendumit në favor të shkrirjes të parakohshme të organit përfaqësues në rang qarku nënkupton përfundimin e veprimtarisë së këtij organi drejtues dhe në bazë të ligjit – edhe të organit ekzekutiv.
3. Nëse në një referendum të vlefshëm për shkarkimin e kryetarit të bashkisë për një arsye të ndryshme nga mungesa e votëbesimit, kundër shkarkimit të kryetarit të bashkisë, është më shumë se gjysma e votave të vlefshme, veprimtaria e këshillit të bashkisë gjithashtu, me ligj, përfundon.

4. Në rastet, e përmendura në paragrafet 1-3, Kryetari i Këshillit të Ministrave cakton menjëherë personin, i cili do të kryejë funksionet e organeve të njësisë së qeverisjes vendore deri në kohën e zgjedhjes së organeve të reja të njësisë së qeverisjes vendore, si dhe vendos, me përjashtim të dispozitës së paragrafit 5, mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme.

5. Në rastin e paraqitjes së ankesës kundër vlefshmërisë së referendumit, deri në castin e marrjes së vendimit të formës së prerë për këtë çështje, nuk vendoset mbajtja e zgjedhjeve të parakohshme.

## **KREU VII**

### **ORGANET PËRGJEGJËSE PËR MBARËVAJTIEN E REFERENDUMIT**

#### **Neni 83**

Organet përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji janë: KQZ, organet e njësive të qeverisjes vendore si dhe Grupet Nismëtare. Sipas rastit, këto struktura mund të bashkëpunojnë edhe me organe dhe institucione të tjera publike apo me organizata të shoqërisë civile dhe parti politike.

#### **Neni 84**

##### **Detyrat dhe përgjegjësitë e KQZ-së**

1. KQZ-ja ka rol aktiv në përgatitjen e referendumit, në njoftimin efikas të procedurës së votimit, informimin e publikut për çështjet e shtruara për referendum, zhvillimin e procesit të votimit, numërimin, administrimin dhe shpalljen e rezultatit të referendumit
2. Në lidhje me referendumet, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka këto detyra dhe përgjegjësi:
  - a) mbikqyr ligjshmërinë dhe siguron zbatimin e barabartë të këtij ligji gjatë përgatitjes dhe zhvillimit të referendumit;
  - b) drejton punën e komisioneve të referendumeve dhe shqyrton vendimet e miratuara nga komisionet e referendumit;
  - c) trajton ankesat e ardhura në lidhje me procedurën e përgatitjes dhe zhvillimit të referendumeve;
  - ç) jep sqarime dhe udhëzime për zbatimin e këtij ligji;
  - d) nxjerr në bazë dhe për zbatim të këtij ligji dhe brenda sferës së juridiksionit të saj, vendime dhe udhëzime me fuqi juridike të përgjithshme në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë
  - dh) disponon mjetet financiare të alokuara për mbajtje të referendumeve, shpërndarjen e tyre dhe mbikqyr mënyrën e përdorimit të tyre për mbajtjen e referendumeve;

- e) merr masa për sigurimin e materialeve, mjeteve e bazës teknike si dhe mjeteve të komunikimit përkatëse për të garantuar zhvillimin normal të referendumit;
  - ë) përcakton modelin e fletëve të votimit për referendumin si dhe dokumente të tjera të referendumit;
  - f) përcakton formën e vulës që vendoset në fletët e votimit dhe në gjithë dokumentacionin që shoqëron zhvillimin e referendumit, si dhe përcakton procedurën për kthimin e vulave pas referendumit;
  - g) siguron publikimin në media të draftit të paraqitur në referendum;
  - gj) akrediton përfaqësuesit e mediave dhe organizatave ndërkombëtare që kryejnë misione vëzhgimi, sipas një procedure të përcaktuar nga vetë ky institucion;
  - h) përcakton një procedurë të vetme për përmbledhjen dhe finalizimin e rezultateve të referendumit;
  - i) në përputhje me kërkesat e Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë përmbledh dhe shpall rezultatet e referendumit, si dhe procedurën e dorëzimit të dokumentacionit të përdorur në referendum;
  - j) organizon trajnime për anëtarët e komisioneve të referendumit;
  - k) në rast të shkeljes së kërkesave të këtij ligji, për çështje të organizimit të referendumit, mund t'i drejtohet organeve kompetente përkatëse;
3. Kryen detyra të tjera të përcaktuara në këtë ligj dhe në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

## **KREU VIII**

### **FINANCIMI I REFERENDUMIT**

#### **Neni 85**

#### **Financimi i referendumeve të përgjithshme**

1. Në referendumin e përgjithshëm, të gjitha kostot dhe shpenzimet. mbulohen nga buxheti i shtetit.
2. Kuvendi vë në dispozicion të KQZ-së dhe të institucioneve të tjera përkatëse fondet për përgatitjen, zhvillimin, mbikëqyrjen, si dhe çdo aspekt tjetër të procesit.
3. Shpërndarja dhe përdorimi i mjeteve financiare nga KQZ-ja për mbajtjen e referendumeve, bëhet në përputhje me këtë ligj dhe Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

#### **Neni 86**

#### **Financimi i referendumeve vendore**

1. Shpenzimet e referendumit mbulohen nga buxheti i njësisë së qeverisjes vendore, të cilës i takon referendumit. Kjo nuk i referohet veprimeve të kryera nga KQZ.

2. Në rastin e referendunit në rang qarku, mjetet bazuar në përlllogaritjen e shpenzimeve të referendunit që janë mbartur nga njësitë e qeverisjes vendore, transferohen nga buxheti i shtetit, jo më vonë se 20 ditë përpara ditës së referendunit.
3. Përlllogaritja dhe transferimi i financimit ndërmjet njësive të pushtetit vendor për mbulimin e shpenzimeve të mbajtjes së referendunit duhet të përfundojë jo më vonë se një muaj përpara ditës së mbajtjes së referendunit.
4. Shpenzimet e KQZ që lidhen me organizimin dhe mbajtjen e referendunit për shpërndarjen e parakohshme të organit përfaqësues ose të shkarkimit të organit ekzekutiv të njësisë së qeverisjes vendore para mbarimit të mandatit, mbulohe nga buxheti i shtetit, në pjesën që i takon KQZ.
5. Shpenzimet e grupit nismëtar që kryhen në lidhje me referendumin përballohen nga burimet e veta të tij.
6. Grupit nismëtar të referendunit si dhe subjekteve të tjera, që marrin pjesë në fushatën e referendunit nuk mund t'iu transferohen, ndërsa nismëtari i referendunit nuk mund të pranojë të marrë për qëllime të referendunit, mjetet financiare që vijnë nga:
  - a) buxheti i shtetit;
  - b) buxhetet e njësive të qeverisjes vendore,

me përjashtim kontributeve financiare të personave fizik me kombësi shqiptare dhe personave juridik me ortakë ose aksionerë me kombësi shqiptare, veprimtaria aktive e të cilës, sipas statutit të saj, është e shtrirë të paktën në territorin e njësisë të dhënë të qeverisjes vendore.

6. Dispozita e paragrafit 6 zbatohet edhe për vlerat jomonetare.

## **KREU IX**

### **ANKIMET DHE SANKSIONET**

#### **Neni 89**

#### **Ankimi**

1. Të drejtën e ankimit, kundër vendimeve të KQZ-së kur ato cënojnë interesat e tyre të ligjshëm për referendum brenda afateve të vendosura me këtë ligj, e kanë individët, organizatat e shoqërisë civile ose partitë politike, të cilëve u është refuzuar kërkesa sipas përcaktimeve të këtij ligji.
2. Ankimi paraqitet në Kolegjin Zgjedhor për mosmarrje të vendimit brenda afatit ligjor nga KQZ-ja, sipas parashikimeve të këtij ligji dhe të Kodit Zgjedhor në fuqi.



3. Të drejtën e ankimit, kundër vendimeve të komisioneve vendore apo zonale të cilat vijnë në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji e kanë njësitë e qeverisjes vendore, individët dhe organizatat e shoqërisë civile.
4. Ankimet për veprimet, mosveprimet apo vendimet e marra të organeve të qeverisjes vendore do të trajtohen sipas parashikimeve të dispozitave të Kreut IV, V dhe VI të këtij ligji.
5. Kundër veprimit ose mosveprimit të organeve të tjera shtetërore, ankimi bëhet sipas procedurave përkatëse ligjore në fuqi.

## **Neni 90**

### **Sanksionet**

1. Falsifikimi, shpërndarja ose përdorimi i fletëve të votimit, i dokumenteve dhe bazës materiale, me qëllim ndryshmin e rezultatit të referendumit nëpërmjet paraqitjes në to të të dhënave, që dihen se janë të pasakta, zëvendësimi i të saktave me të rreme ose nëpërmjet futjes në kuti të fletëve të votimit në mënyrë të paligjshme nga personat që kanë për detyrë të administrojnë procesin, ose ka sjellë pasoja të rënda në mbarëvajtjen e votimit, ka cenuar integritetin e rezultatit të referendumit apo ka sjellë pavlefshmërinë e tyre, dënohet me burgim nga tre gjer në shtatë vjet.
2. Dëmtimi, prishja, shkatërrimi me dashje, apo zëvendësimi në kundërshtim me ligjin i pajisjeve, vulave, kodeve të sigurisë apo çdo materiali tjetër të parashikuar nga ligji, kur kryhen nga personat përgjegjës për administrimin e procesit ose në bashkëpunim, ose më shumë se një herë, apo kur kanë sjellë pasoja të rënda në mbarëvajtjen e procesit, kanë sjellë pavlefshmërinë e tyre apo kanë cenuar rezultatin e votimit, dënohen me burgim nga tre gjer në tetë vjet.
3. Shkelja e rregullave që garantojnë fshehtësinë e votimit nga ana e personave të ngarkuar me votimet, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet.
4. Lejimi me dashje nga komisionerët i kryerjes së votimit më shumë se një herë në të njëjtin referendum, votimi për persona të tjerë, duke paraqitur dokumente identifikimi të rreme apo duke përdorur dokumente të votuesve të tjerë dënohet me burgim nga një gjer në pesë vjet.
5. Lejimi me dashje nga komisionerët i votimit, pa kryer identifikimin e shtetasit sipas ligjit, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet.
6. Braktisja e detyrës apo refuzimi për të kryer detyrën nga personat e ngarkuar me administrimin e procesit të votimit dhe të numërimit, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet.
7. Kur veprimet e mësipërme kryhen duke marrë me vete ose duke zhdukur materialet e votimit, ose kur kanë sjellë pasoja të rënda për procesin e votimit apo kanë çuar në pavlefshmërinë e referendumit, dënohet me burgim nga dy deri në shtatë vjet.
8. Shkelja dhe mosrespektimi i dispozitave të tjera të këtij ligji, me përjashtim të rasteve kur përbën vepër penale, cilësohet kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë

.....

## **KREU X**

### **DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT**

#### **Neni 91 Interpretimi**

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji çdo akt tjetër ligjor ose nënligjor, që bie në kundërshtim me të, shfuqizohet.

Dispozitat e këtij ligji plotësohen me parashikimet e Kodit Zgjedhor, me përjashtim të rasteve dhe për atë që ky ligj nuk parashikon ndryshe.

Në lidhje me të gjithë procesin për përgatitjen, administrimin dhe mbajtjen e referendumit si dhe rezultatin e tij, në rast nevojë për interpretim, prioritet kanë dispozitat e këtij ligji.

#### **Neni 92 Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.....datë.....të Presidentit të Republikës.....